

# REPRESENTATION OF THE WORD OF HONOUR IN NOVEL OF KADARE

## TRAJTIMI I BESËS NË NJË ROMAN TË KADARESË

Kamber KAMBERI<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Gjakova „Fehmi Agani“

\*Corresponding author e-mail: kamber.kamberi@uni-gjk.org

---

### Abstract

The word of honour given for something or for an issue is encountered as a topic in different peoples in the form of oral tradition which come from ancient times, and which is later represented in written form. To Albanians, the word of honour, or in other words *besa*, has a more complex, more sublime meaning and takes on a character with an emotional and moral weight. So it is a call to fulfill something that has been promised in advance and that must be fulfilled.

*Besa* as a theme has been represented in a number of Kadare's works, but in a more complex approach it is found in the novel "The Ghost Rider" (in Alb.: "Kush e solli Doruntinen"). This is an early theme that comes from legends and other variants are also known as sisterhoods to different peoples, especially the peoples of Balkan. Therefore, in order to approach this intriguing topic that is represented in Kadare's novel, one must necessarily approach it by the analytical, synthesizing, comparative, sociological and historical method.

Therefore, it is of interest to raise this complex topic to simplify how the author operates in the functioning of temporal interconnection, rejuvenating the themes of legends with a masterful inscription that naturally interconnects the transcendental mission. Also, how does he complete the picture, from a distant background of memory with other additional narratives, events and happenings, or even other artistic figures that carry the starting point of the narrative of the event to the compliance with the topicality of the time. Always with the mission of courage for positive treatment in focusing the message on combating social paradoxes.

**Keywords:** *Besa, Ghost Rider, Doruntina, Kadare, legend.*

### Përmbledhje

Fjala e dhënë për diçka apo për një çështje, haset si temë te popujt e ndryshëm në formë të gojëdhënave, të cilat vijnë nga kohët e vjetra e që më vonë trajtohen edhe në forma të shkruara. Te shqiptarët fjala e dhënë apo thënë ndryshe *besa*, ka një kuptim më kompleks, më sublim dhe merr një karakter me ngarkesë emocionale e morale. Pra, është një thirrje për të përmbushur diçka që është premtuar paraprakisht dhe që duhet përmbushur apo realizuar doemos.

*Besa* si temë trajtohet në disa vepra të Kadaresë, por në një qasje më komplekse haset te romani "Kush e solli Doruntinën". Kjo është një temë e hershme që vjen nga legjendat dhe njihen edhe variante të tjera si motërzime te popujt e ndryshëm, sidomos të atyre ballkanas. Andaj, për t'iu qasur kësaj teme intriguese që trajtohet në romanin e Kadaresë, duhet kërkuar doemos me metodën analizuuese e sintetizuese, krahasuese, sociologjike, historike etj.

Prandaj, është me interes të shtrohet kjo temë komplekse për të shëmtuar se si operon autori në funksionimin e ndërlikohjes kohore, duke i rinuar temat e legjendave me një skalitje mjeshtërore që ndërlikoh natyrshëm misionin e tejkohshëm. Gjithashtu, si e bën përplotësimin e tablosë, nga një sfond i largët i kujtesës, me rrëfime të tjera shtesë, ndodhi e ngjarje, apo edhe figura tjera artistike që bartin pikënisjen e rrëfimit të ngjarjes deri te përputhja me aktualitetin kohor. Gjithnjë me misionin e guximit për trajtim pozitiv në fokusimin e mesazhit për luftimin e paradokseve shoqërore.

**Fjalët kyçe:** *Besa, Doruntina Kadare, Kostandini, legjenda.*

---

## Besa si veçori e arbërorëve

Romani “*Kush e solli Doruntinën*”, vjen nga një temë e marrë nga balada e njohur arbërore, “*Kostandini dhe Doruntina*”. Ismail Kadare, këtë baladë e transformon artistikisht me metoda letrare duke e sjellë si variant dhe kontekst shumë më ndryshe, që kap një trajtim më të gjerë e më kompleks të çështjes. Pos temës bosht të *besës*, me të është e lidhur dilema, zhurma, hamendësimet, përfoljet, gjykimet dhe pritjet e përgjigjes së pyetjes: *Kush e solli Doruntinën*, apo edhe *kur dhe pse* e sollën atë. Edhe pse trajton një temë që vjen nga lashtësia, këtu me shtresimet e saja nëntekstore, është e përshtatur artistikisht dhe përçon kumte edhe për bashkëkohësinë e autorit.

Ngjarjet zhvillohen, kryesisht diku në trojet shqiptare në kohët mesjetare, vend dhe kohë që përshtatet me rregullimin shoqëror edhe me vendet tjera të nënqiellit të përbashkët evropian. Në këtë hapësirë të përbashkët, atëherë, ku e kishte pasur vendin edhe Arbëria e asaj kohe, e më vonë e ndarë dhunshëm nga pushtimet osmane dhe tash së voni, në bashkëkohësinë e autorit, kjo Shqipëri, pa dhe mbase edhe me dashje e kishte humbur, apo *braktisur* këtë hapësirë të përbashkët që e kishte qysh nga kohët e padata.

Tematika e trajtuar këtu, ka ngjashmëri me variantet e përafërta edhe me legjendat simotra ballkanase, apo edhe evropiane, që ndonjëherë janë edhe stereotipe, por edhe qëllimshëm të përvetësuara. Kjo novelë e Kadaresë, në këtë rast vjen nga njëra prej motërzimeve të varianteve të arbëreshëve të Italisë, që si skelet të ndërtimit dhe të mishërimit në një tërësi, ka trajtimin e *besës*.<sup>71</sup> Të *besës* së dhënë nga njëra palë - palës tjetrës, apo *besës* së dhënë nga një person - personit tjetër sikurse në këtë rast, por që inkorporon edhe të tjerët në problematikën e kësaj çështjeje. Dhe kjo fjalë e dhënë, si *besë*, si akt garantues i bërë për diçka, ka rëndësinë e pazëvendësueshme, shpeshherë edhe me sakrificën dhe me çmimin që mund të jetë edhe i shtrenjtë dhe i shumanshëm. Mund të thuhet prandaj, se është si një veçori, apo pasuri shpirtërore e morale dhe simbol i pakontestueshëm i shqiptarëve

*Besa, beja, fjala, apo betimi*, por edhe *feja* në këtë kontekst që del në një ndërlidhje kuptimore me këtë si diçka e shtrenjtë, si diçka e shenjtë, që jepen për diçka të rëndësishme a për një çështje, në kontekstin kuptimor janë pothuajse të përafërta apo e përplotësojnë njëra-tjetrën. Sidoqoftë, *besa*, si justifikim ka kuptimin më kompleks e më të gjerë, të një virtyti më të koduar dhe më përmbajtësor te shqiptarët. Sepse, *besa*, kjo ndodh të jepet zakonisht vetëm në rastet më sublimë, për të garantuar siguri e mbështetje për një çështje që me këtë rast merr një ngarkesë të madhe emocionale e morale, të pakontestueshme për kah përmbajtja dhe rëndësia.

Gjithashtu e parapërcaktuar me kodet dhe rregullat tjera, që janë përgjithësisht të njohura, e veçanërisht të definuara në vetëdijen e besëtarëve, si nyje e pakapërcyeshme në dhënie-marrjet e *besës*. Nyje që ndal edhe frymën, që të rikthen edhe frymëmarrjen, sfidon vdekjen, ndal edhe kohën dhe ka vetëm një shteg të udhës që domosdoshmërisht duhet ndjekur, lirim nga barra e një pengu, pra të fjalës së dhënë, *besës*. Veprimi është i ndërthurur me thelbin e çështjes së *besës* që bartet nga personazhet kryesorë Kostandini dhe Doruntina, por që rolin kryesor të fiksonit në ndërthurjen e veprimit dhe zgjidhjen e problemit kyç e ka, apo e bart autori te vetë Stresi, por edhe te Zonja Mëmë. Sidoqoftë, Stresi, pothuajse e merr rolin, apo bëhet heroi i zgjidhjes së çështjes kontestuese. *Besa* e dhënë sikurse në këtë rast nga Kostandini, medoemos duhet përmbushur, duhet kryer gjithsesi, pa përcaktuar kohën apo gjendjen, dhe pa përfillur çfarëdo rrethane të mundshme.

---

<sup>71</sup> “Këtu kemi të bëjmë me një nga baladat shqiptare dhe ballkanike më magjepsëse dhe paradigmatiche, që sipas vetë shkrimtarit Kadare, pikërisht në mjedisin arbëresh ruan një nga variantet më të bukura, më origjinale dhe më të lashta, shprehje edhe e vendit qendror që zë koncepti i *besës* në identitetin dhe kujtesën kolektive të arbëreshëve të Italisë.” Francesco Altimari, parathënie në Veprën 10, *Kush e solli Doruntinën*, Onufri, 2008, f. 162.

Si kodifikim shqiptar, fjala e dhënë mbetet si peng që gjithsesi duhet kryer, qoftë edhe duke tejkaluar kufijtë e së mundshmes e të reales, duke e sfiduar edhe vetë vdekjen, si në rastin e Kostandinit. Ai, shfaqet i ringjallur edhe duke ikur nga ajo vdekje përkohësisht, në një ringjallje të përkohshme, për atë kohë sa nevojitet për të kryer misionin e ngarkuar. Pra, metaforikisht edhe duke bërë aleancë me të pabërën, apo duke i dhënë *besën* figurativisht edhe vdekjes për kthim në mbretërimin e saj të përhershëm, sapo të kishte zgjidhur problemin e *besës* së dhënë.<sup>72</sup>

Ky akt sublim, nderimi i *besës*, si veçori dalluese, dhe e identifikuar për shqiptarët, e njohur tashmë gjithandej në Ballkan dhe më gjerë, përçohet tejkohshëm nga lashtësitë dhe brend kohëpaskohshëm që andej, në thirrje për të përmbushur diçka të pa kryer. Diçka të mbetur si peng, apo një nyje që sado e shtrënguar, ajo doemos duhet zgjidhur. Gjithashtu, *besa* mbahet edhe nëse të përcaktohet me fatin e jetës, deri në flajm. Kjo *besë* e tejmoçme, dëshmohet shumë herë në letërsinë gojore, edhe te cikli i këngëve të kreshnikëve, “*Mujit e Halilit*”.

Halili i zënë rob, në burg, i kërkon leje për një kohë të caktuar çikës së krajlit duke i dhënë *besën* se, do të kthehet përsëri në burg, në kohën e caktuar, sapo të kryente një punë të domosdoshme, të pakryer, apo të merrte pjesë në një ndodhi të veçantë familjare. Dhe me të përfunduar misionin, ai, kthehet për *besën* e dhënë, përsëri aty në qelitë ku ishte i burgosur më parë, në kohën kur e kishte dhënë *besën* paraprakisht. Nisur nga kjo, *besa*, paraqitet si e gjithkohshme për shqiptarët, si diçka sublime, e shenjtë, unike dhe e pacenueshme. Ajo, vjen në mendje, shpeshherë si nevojë, duke i thirrur kohët në rishfaqje, *si besë* apo edhe *besëlidhje*.

Edhe në mbrojtje e ruajtje nga zvetërimi i mundshëm i mospërfilljes, apo nëpërkëmbjes së saj si veçori e identitetit shqiptar. Kjo frymë ndihet jo vetëm këtu në këtë vepër, por edhe në vepra të tjera të Kadarese. Premtimi i dhënë, *besa*, si e gjithëpushtetshme, sovrane për të gjithë shqiptarët, ajo i sfidon të gjitha ligjet, qoftë edhe ato të paprekshmet, edhe hyjnore qofshin. Kjo realizohet në mënyrë të madhërisht apo të jashtëzakonshme nga Kostandini, nga vëllai që i kishte dhënë *besën* së motrës Doruntinës, se do ta vizitonte dhe do ta sillte në familje sa herë të paraqitej nevoja, edhe pse e martuar larg vendlindjes, diku në Bohemi pas nëntë bjeshkëve.

Koha po kalonte, edhe pse kishin kaluar tri vjet që nga martesja e Doruntinës, premtimi i dhënë, *besa*, nuk ishte përmbushur ende. S’ishte përmbushur, sepse në ndërkohë, pas martesës së Doruntinës të nëntë vëllezërit Vranaj, në mesin e të cilëve edhe Kostandini, gjatë një beteje, në përpykje për mbrojtjen e vendit kishin mbetur të vdekur që të gjithë. Kjo krahurë erdhi si pasojë e një mortaje a sëmundjeje tjetër vdekjeprurëse, mbase e përçuar nga ushtria kundërshtarë. Prandaj, si rrjedhojë e këtyre zhvillimeve, fjala e dhënë, *besa*, kishte mbetur peng, premtim i papërmbushur.

Realisht, *besa*, duhej të kishte mbetur e pa kryer me vdekjen e besëdhënësit, por kuptimisht nga rëndësia dhe forca që bart ajo, kurrsesi nuk mund të mbetej si e papërmbushur. Prandaj, forca e saj po shtjellej edhe mbi varrin e vdekëtarit. Mbi këtë peng që kishte mbetur i pakryer nga premtimi i dhënë *besa*, para tri viteve, po thyheshin edhe ligjet e natyrës. Të vdekurin nuk po e treste as dheu. Varri nuk po e lente brenda pa e përmbushur fjalën e dhënë *besën*. Nga ana tjetër, Zonja Mëmë, ndërkaq ishte e sëmurë, ishte verbuar e shkallmuar rëndë nga tragjedia që e kishte goditur. Ajo, ndodhur në këtë gjendje pikëlluese, tashmë po numëronte ditët e fundit të jetës. Po lëngonte pa shpresë në shtratin e vdekjes, por shpirti po i mbahej si peng, pa u përmbushur një dëshirë të fundit, ta shihte vajzën e saj të vetme, Doruntinën.

---

<sup>72</sup> “Kumti i romanit “*Kush e solli Doruntinën*” nuk mund të ndahet nga kodi etik tradicional shqiptar, brenda të cilit *besa* zë një vend qendror. Por vetëm ringjallja, e ardhur prej letërsisë ungjillore, prej Besëlidhjes, i jep fuqi individit të nderojë kodin e tij fisnik. Në njëfarë mënyre autori u shprehet lexuesve se nderimi për *besën* është nderim për ringjalljen dhe se një vlerë juridike e etike nuk do të kishte atë shkëlqim pa frymën evangjelike, ungjillore.” Shaban Sinani, Për prozën e Kadarese, Onufri, Tiranë, 2009, f. 112.

Së fundi lëshon mallkimin mbi të birin e saj Kostandinin, që nuk po ia sillte atë, as tash kur po numëronte çastet e fundit të jetës, me gjithë *besën* e dhënë paraprakisht se ai do t'ia sillte sa herë që të dëshironte ajo. Në këtë rast duhet të veprojë vetëm forca e *besës* për të zgjidhur problemin, që me misionin e saj e bën të paimagjinueshmen. Në anën tjetër edhe forca e mallkimit dhe aftit të nënës si nxitje, kapërcejnë gjithçka që del si pengesë, apo barrierë që duket e pakapërcyeshme. Thirrja depërton edhe në tjetërbotë. Fuqia e thirrjes dëshpëruese e mallkuese, njëkohësisht e sfidon atë edhe në pajatësi, për një kthim në tjetër gjendje që është e përkohshme. Misioni i besës, pra shkakton tronditje, i jep shpirt për ringjallje. Tjetërqysh, e qet edhe nga varri, nga një botë e përtejme, në një botë të këtejme, të gjallshme.

Nga gjithë kjo shungullimë e rrëmujshe, Kostandini ringjallet dhe ngritët për të kryer apo hequr barrën e misionit të *besës*. Me gjithë këtë ngarkesë hipur në kalin e baladave, ai, merr rrugën e gjatë, përtej nëntë bjeshkëve. Pas tri vjetësh të vdekjes, pas tri javësh nga mallkimi që kishte ardhur nga Zonja Mëmë për ta sjellë të motrën Doruntinën. Tek ajo nënë e sëmure që po lëngonte në shtratin e vdekjes që prej kohësh. Pas gjithë, asaj mynxyre, pas gjithë atij trishtimi, pas gjithë asaj tragjedie që i kishte ndodhur familjes Vranaj, forca e *besës* tashmë po ngadhënjente mbi gjithçka, me gjithë vonesën po kapërcehej e pakapërcyeshmja.

Po zgjidhej nyja që ishte lidhur shumëfish dhe kishte krijuar edhe gjendje të ndryshme si peng e që kërkonin zgjidhje. Në njërën anë Zonja Mëmë s'po mund të jepte shpirt, ndërkaq, në anën tjetër Kostandinin nuk po e treste dheu pa e përmbushur, apo përmbyllur fjalën e dhënë *besën*. Në këtë rast, në baladën tonë kemi një ringjallje që e sfidon ringjalljen e Jezusit, por në brendësi e ka edhe ndryshimin. Krishti, ringjallet me një mision që do të jetë i përhershëm, ndërsa ringjallja të Kostantinin është e përkohshme. Ringjallje sa për ta përmbushur premtimin e fjalës së dhënë, *besës*. Pas përmbushjes së premtimit, nënkuptohet se ai kthehet përsëri në botën e të vdekurve. Pra *besa*, në kuptimin e mirëfilltë, nuk cenon asgjë të shenjë, sepse edhe vetë është e shenjtë për shqiptarët.

## **Besa dhe leximet tjera**

Sikurse edhe te veprat tjera të Kadaresë që u bëhen lexime të tjera të shtresuara, e shpeshherë edhe doktrinare nga individë, apo edhe grupe, me qëllime e projekte të caktuara, edhe këtu te "*Kush e solli Doruntinën*", dalin lexime dhe interpretime të ndryshme. Lidhur me këtë çështje, pra me fenomenin e *besës* që nxirret nga konteksti pozitiv dhe i jepet një kahe krejt tjetër në kontekstin negativ e nënçmues, e përkufizon një rast të tillë studiuesi i mirënjohur Shaban Sinani: "*Nga njëra anë, bashkë me tronditjen e mitit të besës, ekziston prirja për të shkuar drejt së kundërtës, që hyjnizimi etnozakonor i fjalës së dhënë nuk është gjë tjetër veçse shprehje e pabesisë që fatalisht i ka munduar dhe i mundon shqiptarët nga një epokë historike në tjetrën (i ashtuquajturi "kompleks i Rozafës": jo nderi fisnik, por kompleksi i tradhtisë dhe pabesisë ka diktuar rrjedhat historike të tyre)*"<sup>73</sup>

Pos këtij deformiteti, mbase të qëllimshëm dhe të stisur nga drejtime të caktuara dhe me qëllime krejt meskine, vjen edhe një lexim tjetër paradoksal, sipas vërejtjes së po të njëjtit autor Sinani. Këtë herë i nisur, apo i adresuar në mënyrë të tërthortë nga një orkestrim i sistemit totalitar komunist, që survejonte, drejtonte dhe përshtaste tekstet sipas nevojave të ditës: "*Nga ana tjetër, simetrikisht me vlerësimin e dikurshëm për nënçmim ideologjik të kohës dhe arratisje në të shkuarën, gjithnjë e më shumë po shfaqet prirja e kundërt, ajo e zbulimit se I. Kadare, përmes këtij romani, përkundrazi, thjesht ka dashur të gjejë në histori kumte në shërbim të komunizmit, të*

<sup>73</sup> Shaban Sinani, *Për prozën e Kadaresë*, Naimi, Tiranë 2009, f. 100.

*shërbejë me veprën e vet “në funksion të krijimit të njeriut të ri” dhe “të mbrojtjes së pastërtisë e homogjenitetit ideologjik”; se shenjtërimi i besës në këtë veprë ka thjesht kuptimin e shenjtërimit të unitetit ideologjik, të kuptuar si një besëlidhje kushtetuese”.*<sup>74</sup>

Prandaj, shihet qartë se ky definim, kjo persiatje që vjen nga vijat e sistemit totalitar, ka qëllime deformuese e relativizuese të çështjes për t’i dhënë ngjyrim dhe kahe tjetër një çështjeje kaq të rëndësishme. Ky interpretim ka edhe qëllimin tjetër meskin për profilizimin dhe fiksimin e deformuar të portretit të shkrimtarit I. Kadaresë. Nisur nga kjo, gjithçka që është e rëndësishme e sublime duhet t’i takojë apo shërbejë partisë. Nuk ka rëndësi nëse këto përshtatje cenojnë integritetin moral të individit, nuk përkojnë dhe nuk lidhen me realitetin, me kohën e as me hapësirën.

Kjo *besë* si një thesar etnozakonor të trashëguar nga lashtësia e shekujve, del si pasuri shpirtërore supreme dhe me mbrojtje të përhershme, si vlerë e shenjtë e arbërorëve. Pa marrë parasysh kohët, ajo mbetet e pacenueshme në integritetin dhe në peshën e përkufizuar paraprakisht. Kohët ndërlidhen dhe komunikojnë me fenomenet shpeshherë, edhe këtu e kemi këtë komunikim. Këtë komunikim midis kohëve, gjithashtu e thotë në një punim të tij studiuesi Sh. Sinani: “*Balada i ka shërbyer autorit si një paratekst dhe pretekst për të mundësuar komunikimin e dy kohëve të lashta historike: të epokës së humanizmit evropian, një prej kohërave më të ndritura të njerëzimit, që e pati praruar disi edhe Arbërinë këtej detit, me atë të bashkëkohësve të vet*”<sup>75</sup>

Pra, pos që shfaqet komunikimi i kohëve, ndërlidhja e kohëve, edhe autori vetë lëvizë nëpër kohë. Pas botimit të veprës dhe trajtimit që i bëhet “*Kush e solli Doruntinën*”, ashtu siç edhe theksohet në një rast, kritika e shpjegoi si dëshirë e autorit për të ikur në kohët e shkuara dhe mungesë e dëshirës për të qëndruar në temat bashkëkohore, pra, “*me një dëshirë dredharake për t’i ikur Shqipërisë së kohës dhe për të lartësuar kohëra të shkuara, ndoshta edhe për të monumentalizuar të shkuarën në dëm e në konkurrim të së sotmes, rregullisht e mbiquajtur “e ndritur”*”<sup>76</sup>. Këtë metodë, të ikjes në kohët e shkuara me qëllim të strehimit më të sigurt nga ku mund të jepen kumte dhe mesazhe të caktuara e hasim edhe në veprat tjera të tij.

I. Kadare, romanin *Kush e solli Doruntinën*, spikamën e ndërtimit e nis nga legjendat tona të vjetra, të një varianti mbase më të bukur e më origjinal të marrë prej arbëreshëve të Italisë, si copë e shkëputur nga i njëjti nënqiell arbëror. Ky variant, është i krahasuar edhe me elementet e huazimeve nga simotrat tjera të gadishullit mitik. Vepra është përmbaaruar nga tharmi i këtij brumi nismëtar, shtuar edhe me komponentë tjerë imagjinativë, gjithnjë të harmonishëm dhe funksionalë në tërë prologun e saj.

Në këtë ndërtim të veprës, ka edhe elemente tjera letrare, që i japin një gjallëri të lidhur për një dramacitet të vazhdueshëm përgjatë gjithë veprimit, kështu, dashur e padashur të sjellë në botën e mendimit të thellë dhe në kahet imagjinare, me hamendësimet për zgjidhjen e epilogut përfundimtar. Kjo shtrirje e veprimit të mban peshë, dhe atëherë kur lexuesi mund të ketë imagjinuar e fiksuar në mendjen e tij shumë mundësi të zgjidhjeve në epilogut përfundimtar, befas shfaqet zgjidhja më e pranueshme dhe më përmbajtësore. Kjo provohet edhe nga dyshimet, hamendjet, intrigat apo gjyqet që bëhen përgjatë gjithë veprimit që vjen nga rrëfimi i veprës. Nga gjithë situata kaotike që kishte shkaktuar forca e fjalës së dhënë, *besa*, që në këtë rast del jashtë mendjes esëll, duke parashtruar të vetmen pyetje dhe kërkuar të vetmen përgjigje, *kush e solli*

<sup>74</sup> Vepra e cituar, f. 100.

<sup>75</sup> Shaban Sinani, *Për prozën e Kadaresë*, Naimi, Tiranë, 2009, f. 99.

<sup>76</sup> Vepra e cituar, f. 99.

Doruntinën?<sup>77</sup> Dhe këto mëdyshje në librin *Ftesë në Studio*, i sqaron vetë Kadare: “Mëdyshje për Doruntinën, heroinën e romanit “Kush e solli Doruntinën?”. Të gjitha pyetjet që janë bërë prej lexuesve, (disa herë prej kritikëve), se kush e solli në të vërtetë Doruntinën, nusen e martuar larg që kërkon ta besojnë se e ka sjellë vëllai i vdekur, më kanë torturuar së pari mua vetë. Si njeriu që lëviz në shtrat për të larguar gjumin e keq, kam arritur gjer më sot t’i shmang.

Gjatë tundimeve të shkurtra për të gjetur një sjellës, personazhi që më shumë më është afruar si hije ishte Sresi vetë, pikërisht ai që merret me hetimin e çështjes. S’është e rastit ndoshta që romani nis me një mungesë të tij gati dyjavore (aq sa është koha e udhëtimit të Doruntinës), mungesë që ai as e përmend, thua se as vetë nuk e mban mend.”<sup>78</sup> E gjithë kjo hamendje e dilemës së madhe, që vjen nga kohët e legjendave të padata, dhe që kërkon përgjigje të guximshme e të vendosur në kohët moderne e jep përgjigjen vetë autori i veprës. Përgjigje e gërshetuar me elegancën artistike të një trajtimi letrar e filozofik, vendosmërisht e shpërfaq, gjeniu i letrave I. Kadare.

Këtë zgjidhje e bën përmes kapiten Stresit të atëhershëm, por që del me mesazhe e kumte edhe të kësaj kohe. Kjo shfaqet përpara atyre që donin të bënin gjyqin e kësaj ngjarjeje të ndodhur, si e pazakontë, apo përpara atyre që donin dhe medoemos duhej ta dinin. Përpara gjithë atyre që prisnin të vërtetën, pas gjithë asaj mjegullnaje të krijuar kaheër dhe gjithë atij makthi të gjatë: “Ju keni dëgjuar, besoj, se kjo krushqi e largët, e para e një largësie të tillë, nuk do të bëhej në qoftë se Kostandini, njëri prej vëllezërve të nuses, nuk do t’i jepte besën nënës se do t’ia sillte Doruntinën sa herë që të lipsej, në gaz apo në zi. Dhe ju e dini pastaj se sa shpejt erdhi koha e zisë për Vranajt dhe për Arbrin, por Doruntinën nuk e solli dot askush, sepse dhënësi i besës, Kostandini kishte vdekur. Ju keni dëgjuar për mallkimin që Zonja Mëmë i bëri të birit për shkeljen e besës dhe e dini pastaj se tri javë pas këtij mallkimi Doruntina erdhi, më në fund, në shtëpi. Ja përse unë e shpall dhe e rishpall se Doruntinën nuk e solli askush tjetër, veçse vëllai i saj, Kostandini, fjala e dhënë e tij, besa e tij”<sup>79</sup>

Kjo dilemë e përmjegullt, shpeshherë paradoksale e parashtruar kaheër dhe që del këtu si nyje, apo si pikëpyetje e madhe, pas përmbushjes së premtimit të mistershëm, mund të kërkohej te një funksionalizim i një force, apo mbiforce. Mbase, të një shtyse ngulmuese apo siç e sheh profesor Shaban Sinani, në mënyrë të vendosur e të prerë, i urdhëruar nga një fjalë e shenjtë e gjithë botës arbërore. Besës. Nga kjo komponentë e parashtruar me një stil të përsosur, me trill të stërholluar artistik e filozofik dhe gjithashtu me guximin intelektual, i thyen të gjitha shabllonet paraprake që ishin të ngurtësuar. Ky guxim i mëvetësishëm i Ismail Kadaresë, bart mbi vete ngarkesën e çmuar të kumtit e të mesazhit të shumëfishtë interkomunikativ, e të tejkohshëm:

“Asnjë shpjegim tjetër s’ka e s’mund të ketë ky udhëtim. S’ka rëndësi, u ngrit apo s’u ngrit i vdekuri nga varri, për ta kryer vetë atë që duhej ta kryente, s’ka rëndësi cili qe kalorësi dhe ç’kalë shaloi ai atë natë të errët kur u nis, ç’krahë mbanin frerin dhe mbi flokët e kujt binte pluhuri i

<sup>77</sup> “Pasi ka shqyrtuar e rishqyrtuar imtësisht të gjitha burimet dhe mundësitë e përveçimit të njeriut a fuqisë që ktheu Doruntinën në gjini, me përgjegjësinë e një hetuesi të kohëve moderne, kapiten Stresi, pikërisht në çastin kur pritet të çmitizojë thelbin e legjendës, duke mbërritur tek e fshehta e kyçur shekull pas shekulli brenda zhguallit të fortë të këngës legjendare, në mënyrë më të befasishme, para se të japë dorëheqjen, në praninë e udhëheqjes së ipeshkvinjve, pohon të pabesueshmen; Doruntinën, princeshën e martuar “nëntë male larg, tutje në Bohemi”, e ktheu në principatën ku ai shërbente prej aq vitesh me një devotshmëri të njohur Kostandini, vëllai i ngritur nga varri, për të mbajtur fjalën që kishte dhënë në të gjallët e tij, i urdhëruar nga ajo fjalë e shenjtë e gjithë botës arbërore, që gjithnjë e më shumë po njihet edhe ndër popuj të tjerë: “besa”, apo, sikundër kishin nisur ta shkruanin të huajt në formën latine, “baesa”. Shaban Sinani, *Për Prozën e Kadaresë*, “Naimi”, Tiranë 2009, f. 98.

<sup>78</sup> Ismail Kadare, *Ftesë në Studio*, Onufri, Tiranë, 2004, f. 51.

<sup>79</sup> Ismail Kadare, *Vepra 10, Kush e solli Doruntinën*, Onufri, Tiranë, 2008, f. 312.

udhës. *Secili nga ne ka pjesën në këtë rrugëtim, sepse besa e Kostandinin, ajo që e sollli Doruntinën, ka mbirë këtu, midis nesh. Ndaj, për të qenë më i saktë, do të thosha se Doruntinën, duke e sjellë Kostandini, e sollëm ne të gjithë, të vdekurit tanë që pushojnë atje te kisha, ju që jeni këtu, unë...*<sup>80</sup>

Në këtë rast, përmbledhshëm spikaten ngarkesat, që kanë të bëjnë me spikamën e identitetit të hershëm të shqiptarëve. Me përbashkësinë e tyre të gjithmonshme, dhe jo vetëm me karakterizimin e *besës* si diçka të tejkohshme, për të gjithë shqiptarët. Stresi, duke parashtruar gjendjen e rëndë në botë dhe pozicionin e Arbrit në këtë kohë krimesh e pabesish, ose në këtë "*pabesnajë*", është në zgripç, të shfityrohet për t'iu nënshtruar fytyrave tjera, pra, ose të ruajë identitetin ose fytyrën e amshuar: "...Dhe në qoftë se gjindja jonë ka nisur të përpunojë në thellësitë e veta ngrehina të tilla sublime, siç është besa, kjo dëshmon se Arbri është duke e bërë, ndërkaq, zgjedhjen e vet. Ai do të ruaj fytyrën e vet të amshuar. Dhe ç'është kryesorja, ai do ta ruaj atë fytyrë jo duke u veçuar si egërsirë nga bota, por duke bërë krushqi me botën. Këtë kumt u ngrit për t'i sjellë Arbrit dhe gjithë njerëzve, nga fundi i gropës ku qe shtrirë, Kostandini."<sup>81</sup>

Pra, *besa* mbetet e pandashme nga rrënjët e thella autoktone të Arbrit. Dhe kjo si e tillë, me gjithë peshën e saj do të mbetet edhe në kohët që do të vijnë. Kështu brez pas brezi, me flijime e sakrificat tjera që kërkohen për t'u mbrojtur. Ajo është e pandashme me gjithë trugun dhe degëzimet identifikuese, që përplotësohet nga elemente tjera shtesë. Autoktonia dhe lëvizjet e arbërve, orientimet e përbashkëta të tejkohshme, ishin gjithnjë të lidhura kah perëndimi. Gjithashtu, aleancat miqësitë dhe krushqitë, dhënie-marrjet, vajtje-ardhjet e vazhdueshme, zakonet e ligjet, kodet e emërtimet, apo edhe titujt e tyre që ishin të përbashkët. Dhe gjithçka që është fisnike, apo edhe huqet, duke e përfshirë krejtësisht, kulturën e kahershme perëndimore.

Këto ndërtime të reja, apo rindërtime letrare, me tematikë dhe elemente bazike të huazuara nga epika jonë legjendare, me tërësinë lëndore, janë përzgjedhur mjeshtërisht me ndjenjën e hollë intuitave. Këto përfundimisht, apo të finalizuara, kristalizohen me efekte artistike brilante, e shpeshherë befasuese, që di t'i ofrojë vetëm Kadare. Ai operon me aftësinë gjeniale të funksionalizimit butaforik kohor, duke i rinuar temat e përshtatur kohëve, apo natyralizuar harmonishëm e gërshetuar me fije të natyrshme ndërlihdhëse. Përplotësimin e tablosë, nga një sfond i largët, e bën me sajesa tjera shtesë, ndodhi dhe ngjarje, apo edhe figura historike, që bartin pikënisjen e maskuar gjer te pikëprurja aktuale kohore. Vepër e ndërtuar gjithnjë me misionin guximtar të shestimit, të kumtit e mesazhit paqësor, që janë gjithmonë në kontekstin pozitiv të çështjeve dhe luftimit të përhershëm të paradokseve ndërshoqërore.

## Referencat

- [1]. Aliu, Ali, *Miti ballkanik te Kadareja*, Onufri, Tiranë 2006.
- [2]. Baçi, Agim, *Përse e sollën Doruntinën*, Onufri, Tiranë, 2013.
- [3]. Gjoka, Behar, *Kadare i rilexuar*, Princi, Tiranë 2008.
- [4]. Kadare, Ismail, *Ftesë në Studio*, Naim Frashëri, Tiranë 1990.
- [5]. Kadare, Ismail, *Dialog me Alain Bosquet*, Onufri, Tiranë 2004.
- [6]. Kadare, Ismail, *Dantja i pashmangshëm*, Onufri, Tiranë, 2005.
- [7]. Kadare, Ismail, *Vepra 10, (Kush e sollli Doruntinën)* Onufri, Tiranë, 2008.
- [8]. Kuçuku, Bashkim, *Kadare në gjuhët e botës*, Onufri, Tiranë, 2006.
- [9]. Mandala, Matteo Mandala, *Ismailand-i dhe urat kronotopike kadareane*, Hylli i dritës, nr.1. Shkodër 2009.
- [10]. Sinani, Shaban, *Për prozën e Kadaresë*, Naimi, Tiranë, 2009.

---

<sup>80</sup> Vepra e cituar, f. 313.

<sup>81</sup> Vepra e cituar, f. 315.